NJË DHURATË E VYER NGA INTELEKTUALI KORÇAR, PËRKTHYESI DHE PERSONALITETI I LETRAVE, Z. GJERGJ ÇIÇO



Këto ditë mora një dhuratë shumë të çmuar nga një intelektual i shquar korçar, përkthyes, aktivist dhe personalitet i letrave shqiptare, kryetar i Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve të Korçës, z. **Gjergj Çiço**. Me përkushtimin e tij, ai na sjell në shqip veprën monumentale *NAPOLEON* të autorit amerikan **Thomas E. Watson (1856–1922)**, një biografi e jashtëzakonshme mbi jetën, karakterin, luftërat dhe arritjet e Napoleon Bonapartit.

Watson ishte politikan, jurist, publicist dhe shkrimtar nga Xhorxhia, SHBA. Përveç karrierës së tij politike, ai la pas disa vepra historike e biografike të rëndësishme, ndër to edhe këtë libër të botuar më 1896, kushtuar figurës së NAPOLEON BONAPARTIT.

DISA FJALË RRETH LIBRIT

Napoleon është një biografi e plotë (rreth 700 faqe) që përshkruan jetën e perandorit francez nga fëmijëria në Korsikë, ngritja marramendëse në fushatat italiane e egjiptiane, pushtetin si Konsull i Parë e më pas

Perandor, deri tek rënia e tij pas Vaterlosë dhe vdekja në Shën Helenë. Përkthyesi e ka sjellë atë në 558 faqe. Libri sjell një panoramë të gjerë mbi: Ambicien dhe gjeniun ushtarak të Napoleonit, Përballjen me vështirësitë, Tensionin mes idealeve të Revolucionit Francez dhe pushtetit absolut, Stilin e tij të udhëheqjes, Trashëgiminë e përzier mes reformave madhore dhe kostove të rënda njerëzore e politike.

Watson arrin të japë një rrëfim të gjallë e të pasur duke e paraqitur Napoleonin si gjeneral, perandor dhe njeri me virtyte e dobësi.

MIRËNJOHJE

Falë përkushtimit të përkthyesit Gjergj Çiço dhe botimit estetik, të bukur e të përgatitur me kujdesin e hollë të prof. dr. Bardhyl Musait dhe shtëpisë botuese EduAlba, lexuesi shqiptar ka sot në duar këtë vepër madhore. Një arritje që pasuron bibliotekën tonë kombëtare dhe i hap lexuesit një dritare të re mbi figurën e një prej personaliteteve më të mëdha të historisë botërore.

Faleminderit z. Çiço dhe prof. Musai për këtë dhuratë të vyer dhe për kontributin tuaj të pandalur në shërbim të kulturës shqiptare.

MB